

**Shpallje për lëvizje paralele  
Ngritje në detyrë  
Pranim nga jashtë shërbimit civil  
në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese**

**Përgjegjës në Zyrën Rajonale Statistike Kukës, në Drejtorinë e Gjeoinformacionit, Mbledhjes së të Dhënave dhe Statistikave Rajonale, në Drejtorinë e Përgjithshme të TI dhe Mbledhjes së të Dhenave, Instituti i Statistikave.**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të kreut II dhe III, të vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Instituti i Statistikave shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

**Përgjegjës në Zyrën Rajonale Statistike Kukës, në Drejtorinë e Gjeoinformacionit, Mbledhjes së të Dhënave dhe Statistikave Rajonale, në Drejtorinë e Përgjithshme të TI dhe Mbledhjes së të Dhenave, Instituti i Statistikave – kategoria III-2.**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil.*

Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**LEVIZJE PARALELE:**

**24 Mars 2026**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**NGRITJE NE DETYRE:**

**27 Mars 2026**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**PRANIM NGA JASHTË  
SHËRBIMIT CIVIL:**

**27 Mars 2026**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

Përgjegjësi i Zyrës Rajonale Statistike është drejtuesi i strukturës së zyrës rajonale statistikore dhe ka varësi të drejtpërdrejtë nga drejtori i Drejtorisë së Gjeoinformacionit, Mbledhjes së të Dhënave dhe Statistikave Rajonale.

Përgjegjësi i Zyrës Rajonale Statistike menaxhon procesin e mbledhjes së të dhënave që përfshin angazhimin në planifikimin, koordinimin dhe organizimin e aktiviteteve të vrojtimeve në terren, krahas përdorimit me ekspertizën e duhur të sistemeve, metodologjisë dhe instrumentave efikase të mbledhjes së të dhënave dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të procedurave dhe standardeve të vendosura në strukturat përkatëse në INSTAT.

Ushtron mbikëqyrjen e veprimtarisë operacionale të specialistëve, mbikqyrësve, intervistuesve apo personelit tjetër të përfshirë në proces, si dhe monitoron aktivitetet e Zyrës Rajonale Statistike dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit dhe grafikut vjetor të vrojtimeve statistikore apo sugjerimeve / rekomandimeve të lëna gjatë kontrolleve dhe auditimeve eventuale.

## **1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë së ulët drejtuese;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo " Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/Natyrore/Bujqësore/Shoqërore. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

**Kandidatët që aplikojnë bashkë me kërkesën duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, kodin e shpalljes publike dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda datës **24 Mars 2026**.

Në datën **26 Mars 2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Ligji nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” ([http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr17-dt-542018\\_per-statistikat-zyrtare.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf));
2. Ligji nr.152/2013, “Për Nëpunësit Civil” (Për Shërbimin Civil (dap.gov.al);
3. Programi i Statistikave Zyrtare <https://www.instat.gov.al/media/11716/1-psz-2022-2026-shqip.pdf>
4. Rregullore e Brendshme e Institutit të Statistikave  
<https://www.instat.gov.al/media/14078/rregullore-e-brendshme-instat-e-ndryshuarshtator-2024-19092024.pdf>
5. Rekomandimet e FAO-s për Censin e Njësive Ekonomike Bujqësore - World Programme for the Census of Agriculture 2020, Vëllimi 1 dhe Vëllimi 2  
<https://openknowledge.fao.org/server/api/core/bitstreams/c5afd226-08ab-4cda-bc45-871f1f95a3be/content>; <https://openknowledge.fao.org/server/api/core/bitstreams/9c31f984-d6d0-47af-bc13-f05df9fe002f/content>

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
  - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
  - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## **2 NGRITJA NË DETYRË**

---

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Institutit të Statistikave, duke filluar nga data **07.04.2026**.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

---

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë ekzekutive;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo " Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/Natyrore/Bujqësore/Shoqërore. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, kodin e shpalljes publike dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brënda datës **27 Mars 2026**.

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Duke filluar nga data **7 Prill 2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të shpallë në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2.4

### FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

---

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## 2.5

### MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

---

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **40 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## 2.6

### DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Drejtoria e Burimeve Njerëzore në INSTAT do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Institutit të Statistikave, duke filluar nga data 07.04.2026.*

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Institutit të Statistikave, duke filluar nga data **07.04.2026**.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë dhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### 3.1

#### **KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

---

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo " Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/Natyrore/Bujqësore/Shoqërore. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

## **3.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, kodin e shpalljes publike dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brënda datës **27 Mars 2026**.

## **3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Duke filluar nga data **7 Prill 2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të shpallë në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## **3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

---

**Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4**

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **40 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **3.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Drejtoria e Burimeve Njerëzore në INSTAT do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

***Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit nga jashtë, do të marrin informacion në faqen e Institutit të Statistikave, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:***

- ***për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,***
- ***datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.***

***Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Institutit të Statistikave duke filluar nga data 07.04.2026.***